



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 48-a, paragrafi (1), pika 1) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21, 74/24 dhe 16/25) dhe pikës 6) nga Vendimi për përcaktimin e instrumenteve të garancisë gjatë zbatimit të operacioneve monetare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.275/24), Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

Listën e letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare

1. Me këtë Listë të letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare (në tekstin në vijim: Lista) përcaktohen llojet e letrave me vlerë që Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vijim: Banka Popullore) i përdor si instrumente për garanci gjatë zbatimit të operacioneve monetare, si dhe koeficientëve të mbulimit.

2. Banka Popullore si instrumente për garanci gjatë zbatimit të operacioneve monetare i përdor këto letra me vlerë të borxhit:

- letrat me vlerë për qëllime monetare të emetuara nga Banka Popullore;
- letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut përmes emetimeve parësore në tregun e brendshëm financiar me anë të ankandit; dhe
- eurobonot e emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në tregjet financiare ndërkombëtare.

3. Gjatë zbatimit të operacioneve monetare për sigurimin e përkohshëm të likuiditetit në denarë, Banka Popullore zbaton koeficientët e mbulimit si raport ndërmjet vlerës së instrumenteve të garancisë dhe mjeteve monetare të miratuara.

Koeficientët e mbulimit arrijnë në:

Lloji i instrumenteve për garanci	Afati deri në maturim					
	Deri në 12 muaj	Mbi 12 muaj deri në 3 vite	Mbi 3 deri në 5 vite	Mbi 5 deri në 10 vite	Mbi 10 deri në 15 vite	Mbi 15 vite
- Letrat me vlerë për qëllime monetare të emetuara nga Banka Popullore - Letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut përmes emetimeve parësore në tregun e brendshëm financiar me anë të ankandit	1.02	1.05	1.10	1.15	1.25	1.50
Eurobono të emetuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në tregjet financiare ndërkombëtare	1.03	1.05	1.09	1.12		

Nëse gjatë përcaktimit të vlerës së instrumenteve të garancisë zbatohet çmimi teorik, përgjatë koeficientëve të mbulimit të përcaktuar në tabelën e kësaj pike, Banka Popullore zbaton koeficientë shtesë të mbulimit në lartësinë prej 1,05.

4. Shuma e letrave me vlerë, të cilat përdoren për garancinë e mjeteve monetare të miratuara, llogaritet sipas formulës:

$$\text{shuma e letrave me vlerë} = \frac{\text{mjetet monetare të miratuara} * \text{koeficienti i mbulimit}}{\text{çmimi i letrave me vlerë}} * 100$$

Gjatë përcaktimit të vlerës së letrave me vlerë të cilat janë të emetuara në valutë të huaj dhe për letrat me vlerë me klauzolë valutore ose kur mjetet monetare të miratuara janë në valutë të huaj, zbatohet kursi i mesëm nga Lista e kursit të këmbimit të Bankës Popullore në datën e vlerësimit.

5. Nëse vjen deri në ekspozim gjatë kohëzgjatjes së operacionit monetar si rezultat i ndryshimit të çmimit të letrave me vlerë, Banka Popullore ka të drejtë të kërkojë menjëherë mbulim shtesë në instrumentet përkatëse të garancisë ose mjete monetare.

Shuma minimale mbi të cilën Banka Popullore kërkon mbulim shtesë është në lartësinë prej 0,1% e mjeteve monetare të miratuara.

6. Me ditën e fillimit të zbatimit të kësaj liste pushon së vlefshmi Lista e letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 152/20 dhe 3/22).

7. Kjo listë hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-7070/5
4 mars 2025
Shkup

Guvernatorja dhe
kryesuesja e Këshillit Ekzekutiv
të Bankës Popullore të Republikës së
Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска